



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 866/3 prot.

Tiranë, më 12. 07. 2021

### V E N D I M

**Nr. 128, datë 12. 07. 2021**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 104, datë 07.06.2021, të Ç. B., ku pretendohet diskriminim për shkak të *bindjeve politike*<sup>1</sup>, nga ana e Bashkisë Berat.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### K O N S T A T O I:

#### **I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Ankuesi sqaron se, mbështetur në vendimin nr. 410, datë 22.10.2015 të Kryetarit të Bashkisë Berat, është emëruar në pozicionin “Zëvendëskryetar i Bashkisë”, të cilin e ka ushtruar deri në datën 06.08.2019.

Gjatë kohës që ka ushtruar detyrën e Zëvendëskryetarit të Bashkisë Berat, ka qënë anëtar i Partisë Socialiste të Shqipërisë, por në muajin prill 2019 është anëtarësuar pranë subjektit politik Lëvizja Socialiste për Integrim. Sipas tij, ky fakt ka qënë i njohur për të gjithë faktorët politik të rrethit të Beratit, e njëkohësisht edhe për Kryetarin e ri të Bashkisë Berat, i cili filloi ushtrimin e detyrës në muajin gusht të vitit 2019.

Pas emërimit, Kryetari i Bashkisë Berat, me Urdhrin Nr. 562, datë 02.08.2019 ka shkarkuar ankuesin nga detyra e Zëvendëskryetarit të Bashkisë dhe ka urdhëruar zgjidhjen e kontratës individuale të punës. Në këtë kuptim, ankuesi pretendon se në urdhrin e sipërcituar nuk është

<sup>1</sup> Referuar vërtetimit datë 2021, lëshuar nga Lëvizja Socialiste për Integrim, Dega Berat, ankuesi është anëtarë i këtij subjekti politik që nga muaji prill 2019.

sqaruar asnjë motivacion për largimin e tij nga detyra, si dhe nuk është respektuar asnjë procedurë sa i përket njoftimit për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës.

Përsa më sipër, Ç. B. pretendon se është diskriminuar nga ana e Kryetarit të Bashkisë Berat, për shkak të bindjeve politike të kundërta me të, duke e larguar nga detyra dhe duke mos respektuar procedurat e zgjidhjes së marrëdhënieve të punës.

Në përfundim, subjekti ankues kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi konstatimin e diskriminimit të tij nga ana e Bashkisë Berat, për shkak të bindjeve politike, si dhe marrjen e masave për rregullimin e situatës duke e rithyer në pozicionin e mëparshëm të punës.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Diskriminimi përkufizohet nga Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”*

Neni 7 i LMD-së, në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.*

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

**Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:**

Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 104, datë 07.06.2021 të Ç. B. u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/4 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

1. Me shkresën nr. 866/1 prot., datë 15.06.2021, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar<sup>2</sup> informacion nga Bashkia Berat, për ankesën e bërë nga Ç. B.

Me shkresën<sup>3</sup> nr. 3183/1 prot., datë 25.06.2021, Bashkia Berat, në mes të tjerash informoi se: “...Ç. B. ka qenë i punësuar pranë Bashkisë Berat me detyrë Zëvendës Kryetar i Bashkisë. Këtë detyrë e ka mbajtur nga data 26.10.2015 deri me 02.08.2019, në të cilën i kanë përfunduar marrëdhëniet juridike dhe financiare të punës.

*Me Urdhërin nr. 562, datë 02.08.2019 është shkarkuar nga detyra e Zv/Kryetarit të Bashkisë për arsye të mosrealizimit të objektivave dhe gjendjes ekonomike financiare të buxhetit të Bashkisë Berat. Një nga kompetencat dhe detyrat e Kryetarit të Bashkisë, referuar Ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, neni 64/e, përcakton se: Kryetari i bashkisë “emëron, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore, zv/kryetarin/zv/kryetarët e bashkisë dhe i shkarkon ata”. Pretendimet e ankuesit janë të pavërteta dhe të pabazuara në fakte dhe prova. Misioni i organeve të qeverisjes vendore është që të sigurojë qeverisjen e efektshme dhe në një nivel sa më afër qytetarëve. Në muajin shtator 2019 në Bashkinë Berat është konstatuar një gjendje ekonomiko financiare shumë e rëndë, me një bilanc negativ të aftësisë së saj paguese. Fakt ky që ka sjellë si rezultat rishikimin e marrëdhënieve të punës në pozicionin e Zv/Kryetarit të Bashkisë dhe jo vetëm me këtë Zv/Kryetar. Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore harton, miraton dhe zbaton çdo vit buxhetin e vet duke mos krijuar borxhe të mbartura dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, i cili rregullon administrimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor si dhe ligjin për financat*

<sup>2</sup> Argumentimin, lidhur me pretendimet e subjektit ankues.

- Kopje të procedurës së emërimit të Ç. B. në pozicionin e Zëvendëskryetarit të Bashkisë Berat dhe kopje të kontratës së punës.
- Kopje të procedurës së ndjekur dhe parashtrime sa i përket shkakut për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës me ankuesin.
- Informacion dhe kopje të procedurës së emërimit të Zëvendëskryetares/it, dhe nëse është e mundur informacionin mbi përkatësinë politike të saj/tij

<sup>3</sup> Protokolluar pranë KMD-së me Nr. 866/2 prot., datë 02.07.2021

vendore. Aktualisht në Bashkinë Berat është konstatuar një gjendje ekonomiko-financiare shumë e rëndë.

Marrëdhëniet e punës mes Kryetarit të Bashkisë, që është një person politik i zgjedhur pas një procesi zgjedhor dhe zëvendësit të tij, nuk janë thjeshtë marrëdhënie punësimi si me punonjësit e tjerë të administratës publike që gëzojnë një mbrojtje të gjerë nga Kodi i Punës dhe Ligji nr. 152/2013 'Për nëpunësin civil', i ndryshuar, pasi duhet të ekzistojë një marrëdhënie e ngushtë besimi nga ana e Kryetarit, për të deleguar zgjidhjen e detyrave të ndryshme administrative dhe politike, një funksionari që gëzon besimin e tij.

Nga sa u parashtrua më lart, veprimet e Bashkisë janë të ligjshme duke respektuar praktikën ligjore që ka ndjekur e është mbështetur Bashkia Berat...Pretendimet e ankuesit janë të pabazuara dhe absurde dhe për më tepër nuk përshkruajnë faktet dhe rrethanat e çështjes...

Ankuesi pretendon se largimi i tij nga puna është bërë për shkak të bindjeve të tij politike, duke qenë se ka pasur kartën e anëtarësimi në subjektin politik LSI. Bashkia Berat gjithmonë ka siguruar të drejtën e punonjësve për barazi përpara ligjit dhe trajtim të barabartë për çdo punonjës. Në asnjë rast nuk është ushtruar presion ose veprim diskriminues, por çdo veprim është kryer në kuadër të punës dhe mirëfunksionimit të detyrave dhe përgjegjësi të Bashkisë.

Në Bashkinë Berat aktualisht ka punonjës të cilët janë me bindje politike të ndryshme dhe në asnjë moment nuk janë diskriminuar nga Kryetari i Bashkisë ose punonjës të tjerë të saj. Gjithashtu ankuesi në asnjë rast nuk jep fakte dhe prova të cilat vërtetojnë se është diskriminuar nga punëdhënësi...Përveç sa sqaruar më sipër, citojmë se pranë KMD është shqyrtuar ankesa e B. B., i cili ka qenë Zv/Kryetar i Bashkisë Berat në të njëjtën periudhë me ankuesin Ç. B. Procedura e largimit nga puna dhe motivacioni i B. B. ka qenë e njëjtë me ankuesin Ç. B. Komisioneri për Mbrojtjen ndaj Diskriminimit në përfundim të shqyrtimit të vendosi konstatimin e mosdiskriminimit të shtetasit B. B. nga ana e Bashkisë Berat për shkak të bindjes politike..."

Ndër të tjera, Bashkia Berat, ka informuar Komisionerin se Ç. B. i është drejtuar me kërkesë padi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat lidhur me mosrespektimin e procedurës së zgjidhjes së marrëdhënieve të punës dhe afateve të njoftimit, e cila ka pranuar kërkesë padinë e tij. Në vijim, nga Bashkia Berat është ushtruar e drejta e ankimit në Gjykatën e Apelit Vlorë, e cila nuk ka pranuar ankimin e tyre dhe ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

#### **A. Lidhur me trajtimin disfavorizues dhe të padrejtë të pretenduar nga ankuesi.**

Bazuar në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, rezultoi se:

Subjekti ankues, Ç. B. me Vendimin nr. 410, datë 22.10.2015 të Kryetarit të Bashkisë Berat është emëruar në pozicionin Zv/Kryetar i Bashkisë Berat. Me Urdhërin nr. 562, datë 02.08.2019,

është shkarkuar nga detyra e Zv/Kryetarit të Bashkisë Berat dhe marrëdhëniet financiare i kanë përfunduar në datë 06.08.2019.

Referuar Urdhërit nr. 562, datë 02.08.2019, të Kryetarit të Bashkisë Berat, ankuesit nuk i është bërë me dije lidhur me arsyet e largimit nga puna, por referuar këtij urdhri, konstatohet se largimi i tij nga detyra është bërë duke iu referuar nenit 153, të Kodit të Punës. Pra, sipas pretendimit të Bashkisë Berat, largimi i ankuesit nga detyra është bërë për shkaqe të justifikuara që nuk lejojnë, sipas parimit të mirëbesimit vijimin e marrëdhënieve të punës. Gjithashtu, referuar shkresës nr. 3183/1 prot., datë 25.06.2021 të Bashkisë Berat, Ç. B. është larguar nga puna dhe për mosrealizim të objektivave dhe gjendjes ekonomike financiare të buxhetit të bashkisë, por për të vërtetuar këtë fakt Bashkia Berat, nuk ka dorëzuar asnjë dokument që do të shërbente si provë.

Subjekti ankues ka ngritur pretendimin se shkarkimi nga detyra si Zv/Kryetar i Bashkisë ka ardhur për arsye se, është anëtarë i subjektit politik, Lëvizja Socialiste për Integrim<sup>4</sup> (LSI).

Në analizë të fakteve dhe shkakut të pretenduar nga Ç. B., si dhe referuar dokumentacionit dhe kronologjisë së ngjarjeve, Komisioneri konstaton se:

- Ligji nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, në nenin 59 dhe 64 të tij, ka përcaktuar si kompetencë të drejtëpërdrejtë të Kryetarit të Bashkisë, emërimin dhe shkarkimin e zëvendëskryetarit/zëvendëskryetarëve, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore.
- Neni 59/3 përcakton se: “Kryetari i Bashkisë, në kryerjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave të tij, ndihmohet nga një ose më shumë zëvendëskryetarë. Numri i zëvendëskryetarëve caktohet nga Kryetari i Bashkisë, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore. Emërimi dhe shkarkimi i tyre bëhen nga Kryetari i Bashkisë”.
- Këto kompetenca theksohen rishtazi dhe në nenin 64/e, ku citohet se Kryetari i Bashkisë: “Emëron, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore, zv/kryetarin/zv/kryetarët e Bashkisë dhe i shkarkon ata”.
- Ndërsa në nenin 61/5 përcaktohet se: “Me përfundimin para kohe të mandatit të kryetarit të bashkisë, sipas këtij neni, deri në zgjedhjen e kryetarit të ri, funksionet e tij i kryen zëvendëskryetari i bashkisë.....”.
- Sipas të dhënave të KQZ-së gjatë periudhës së vitit 2015-2019, Bashkia Berat është drejtuar nga kandidati i zgjedhur nga subjekti politik, Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI) në kuadër të koalicionit “Aleanca për Shqipërinë Europiane”.
- Referuar të dhënave të KQZ-së në zgjedhjet vendore të vitit 2019, Bashkia Berat drejtohet nga kandidati i zgjedhur nga subjekti politik, Partia Socialiste e Shqipërisë (PS), në kuadër të koalicionit “Aleanca për Shqipërinë Europiane”.

---

<sup>4</sup> Referuar vërtetimit datë 2021, lëshuar nga Lëvizja Socialiste për Integrim, Dega Berat, ankuesi është anëtarë i këtij subjekti politik që nga muaji prill 2019.

- Referuar procesit të zgjedhjeve vendore të vitit 2019, faktohet që subjekti politik LSI ishte kundër zhvillimit të zgjedhjeve dhe nuk mori pjesë në to. Referuar<sup>5</sup> lajmeve dhe kronikave të periudhës përpara zgjedhjeve, ish Kryetari i Bashkisë Berat, P. S. ka kundërshtuar zhvillimin e zgjedhjeve, duke i kërkuar KZAZ nr. 64, lirim të ambienteve të zëna në Pallatin e Kulturës “Margarita Tutulani”, në të kundërt, bashkia do të ndërhynte për të zbatuar dekretin e Presidentit të Republikës, për anulimin e zgjedhjeve të 30 Qershorit.

Për faktet e cituara më sipër, që janë të njohura publikisht, bazuar në nenin 80/3 të Kodit të Procedurave Administrative, ku sanksionohet se: *“Për faktet të cilat janë të njohura publikisht, si dhe për ato fakte të cilat janë të ditura për organin administrativ për shkak të funksioneve të tij, nuk nevojitet verifikim”*, nuk lind nevoja për verifikim.

Për të vlerësuar kompetencat, detyrat dhe rëndësinë që ka marrëdhënia e mirëbesimit mes Kryetarit të bashkisë dhe Zv/Kryetarit i referohemi Rregullores së Brendshme të Bashkisë Berat *“Për organizimin dhe funksionimin e veprimtarisë së administratës së bashkisë”* të miratuar me nr. 737, datë 07.02.2018, në të cilën në nenin 14, përcaktohet se:

Zv/Kryetari i Bashkisë emërohet dhe shkarkohet nga kryetari i bashkisë. Puna dhe kompetencat e tij bazohen në Ligjin nr. 139/2015 *“Për Vetëqeverisjen Vendore”* si dhe ato të parashikuara në këtë rregullore.

Detyrat dhe kompetencat e Zv/Kryetarit të Bashkisë:

1. Zëvendëson kryetarin kur ai largohet për periudha të ndryshme kohe të shkurtëra si.....
2. Zëvendëson kryetarin duke kryer të gjitha detyrat e tij (sipas ligjit) kur ky largohet për periudha më shumë se një muaj.
3. Firmos shkresa dhe dokumente që i delegon kryetari *“në mungesë dhe me urdhër/autorizim/porosi të .....”*.
4. Ndjek probleme të përgjithshme dhe të veçanta të administratës, drejtorive apo strukturave të tjera sipas delegimit që i bën kryetari.
5. Kryeson komisione të ndryshme sipas kompetencës që jep Kryetari i Bashkisë.
6. Merr pjesë në takimet dhe bisedat sipas protokolleve që përcaktohen nga Kryetari i Bashkisë.

Në analizë të detyrave sa më sipër, vlerësohet se marrëdhëniet e punës mes Kryetarit të Bashkisë, që është një person politik i zgjedhur pas një procesi zgjedhor dhe zëvendësit të tij, nuk janë thjesht marrëdhënie punësimi si me punonjësit e tjerë të administratës publike që gëzojnë një

<sup>5</sup> Referuar: [www.gazeta-shqip.com](http://www.gazeta-shqip.com), datë 18.06.2019 “Plas edhe në Berat/Kryebashkiaku i LSI urdhër si Meta: Lironi KZAZ ose do ndërhyjmë me.....”; [www.oranews.tv](http://www.oranews.tv), datë 18.06.2019 “Edhe Bashkia Berat kërkon lirim të ambienteve të KZAZ”.



mbrojtje të gjërë nga Kodi i Punës dhe Ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, pasi duhet të ekzistojë një marrëdhënie e ngushtë besimi nga ana e Kryetarit, për të deleguar zgjidhjen e detyrave të ndryshme administrative dhe politike, një funksionari që gëzon besimin e tij. Pra, marrëdhëniet midis Kryetarit të Bashkisë dhe Zv/Kryetarëve nuk janë thjeshtë marrëdhënie administrative hierarkike, por edhe të natyrës politike.

Në rastin konkret, ndodhemi para një situatë të zgjidhjes së marrëdhënieve të punës për shkak se ankuesi është anëtar i një subjekti politik të kundërt me atë që drejton institucionin. Në këto raste, raporti i besimit që karakterizon marrëdhënien midis Kryetarit të Bashkisë dhe Zv/Kryetarëve justifikon zgjidhjen e marrëdhënieve të punës pasi lidhet ngushtësisht me funksionin e ankuesit si Zv/Kryetar i Bashkisë dhe raporteve konfidenciale, bashkëpunuese dhe të mirëbesimit, si dhe marrëdhënieve të ngushta që duhet të kenë personat që mbulojnë postet e Kryetarit dhe Zv/Kryetarit të Bashkisë. Në këto kushte, largimi i ankuesit nga detyra nuk mund të konsiderohet se është bërë për shkaqe diskriminuese, por ai rezulton i përligjur objektivisht.

Të njëjtin qëndrim, për një çështje të ngjashme ka mbajtur Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, kur me Vendimet Nr. 66, datë 10.06.2019<sup>6</sup> dhe Nr. 167, datë 18.11.2019<sup>7</sup> është shprehur se cënimi i parimit të mirëbesimit mund të shërbejë si një shkak i justifikuar për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7, pika 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri gjykon se subjekti ankues nuk është ekzpozuar para një trajtimi të padrejtë dhe të paligjshëm nga ana e Bashkisë Berat.

Në mungesë të këtij trajtimi, Komisioneri gjykon se nuk kemi të bëjmë me diskriminim për shkakun e bindjes politike, të pretenduar nga ankuesi.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenet 1, 3/1, neni 7/1, nenin 32, pika 1/a), c), si dhe nenin 33, pika 10 të Ligjit Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të shtetasit Ç. B. nga ana e Bashkisë Berat për shkak të bindjes politike.

---

<sup>6</sup> K.M kundër Bashkisë Tiranë.

<sup>7</sup> B. B. kundër Bashkisë Berat

2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONER**

**Robert GAJDA**

(Shkaku: Bindjet politike)

(Fusha: Punësim)